



BURIM RAMADANI: KUSHDO NGA OPOZITA QË NUK BASHKËPUNON, I SHËRBEN QEVERISË IZOLUESE TË KURTIT



Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Burim Ramadani, ka thënë se qytetarët kanë votuar për qeveri të re, jo për vazhdim të qeverisjes izoluese. Sipas tij, në ditët e ardhshme Gjykata

Supreme do të pritët ta japë verdiktin mbi ankesat zgjedhore. Ramadani thotë se nëse kjo mundëson certifikimin e rezultateve, procesi për ndërtimin e institucioneve duhet të fillojë. Ai

ka thënë se kushdo nga opozita që nuk bashkëpunon, i shërbën qeverisë izoluese të Kurtit. Ramadani ka theksuar se ngërçin institucional të mundshëm duhet ta tejkalojë opozita

AKTUALE



SHTËPIA E BARDHË IA TREGOI GABIMISHT NJË GAZETARI PLANET PËR LUFTËN NË JEMEN F.3

KUR DUHET TË JAPIN DORËHEQJE ANËTARËT E QEVERISË? F.5

HARADINAJ DHE LATIFI NDERUAN 49 MARTIRËT E FSHATIT BRESTOC F.6

EKONOMI



CLARK: QËNDRUESHMËRIA DHE E ARDHMJË EKONOMIKE E KOSOVËS DUHET TË SHKOJNË KRAH PËR KRAH F.8

INSTITUTI ATLAS: TË HIQET TVSH-JA NË FATURAT E RRYMËS DHE TË ZBATOHET OPINIONI I AVOKATIT TË POPULLIT F.8

SPORT



KËRKOHET BASHKËPUNIM MË I THELLË KOSOVË - SHQIPËRI NË SPORT F.10

SIPAS KE-së, KOSOVA S'MUND T'I MARRË MILIONAT E PARË NGA PLANI I RITJES PA U KONSTITUUAR KUVENDI F.5



RAFUNA: KALIMI I SHPEJTË NË TREGUN E HAPUR BIZNESEVE MUND T'U SHKAKTOJË HUMBJE TË MËDHA F.8



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mok: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Lukashenko betohet për mandatin e shtatë, sundimi i tij cilësohet “antikushtetues”

MINSK, 25 MARS - Presidenti i Bjellorusisë, Aleksandr Lukashenko, u betua të martën për mandatin e shtatë president, por organizatat për të drejtat e njeriut e cilësuan sundimin e tij “antikushtetues”. Lukashenko i fitoi mbi 86 për qind të votave në zgjedhjet presidenciale të 26 janarit, të cilat u dënuan gjerësisht nga vendet perëndimore si një farsë. “Ato u zhvilluan në kushtet e një krize të thellë të të drejtave të njeriut, në një atmosferë frike totale të shkaktuar nga shtypja e shoqërisë civile, medie dhe pavarura, opozitës dhe të gjithë kundërshtarëve”, thuhet në një komunikatë të përbashkët të dhjetë organizatave bjelloruse për të

drejtat e njeriut të martën. Lukashenko u betua gjatë një ceremonie në kryeqytetin Minsk. Po atë ditë qindra mbështetës të opozitës demokratike bjelloruse organizuan protesta në vende të ndryshme të Evropës, përfshirë në Lituani, Poloni dhe Republikën Çeke, për ta shënuar Ditën e Lirisë së Bjellorusisë. Më 25 mars shënohet përvjetori i shpalljes së pavarësisë së Bjellorusisë në vitin 1918 dhe tradicionalisht festohet nga opozita bjelloruse, shumë prej anëtarëve të së cilës janë detyruar të ikin jashtë vendit, ose janë burgosur nga regjimi i Lukashenkos. Në zgjedhjet presidenciale të janarit, në të cilat nuk u lejua



prania e medie ndërkombëtare dhe vëzhguesve perëndimorë, Lukashenko garoi kundër katër kandidatëve

të tjerë, të cilët të gjithë mbështetën qeverinë dhe politikën e tij. Lukashenko, që ka mbi tri

dekada në pushtet, hodhi poshtë çdo kritikë ndaj zgjedhjeve, ashtu si edhe Rusia, aleatja më e ngushtë e Minskut. Në vitin 2020, pas zgjedhjeve të kontestuara presidenciale që i dhanë Lukashenkos një mandat tjetër, shpërthyen protesta masive, të cilat u shtypën me dhunë nga regjimi. Zgjedhjet u dënuan gjerësisht si të manipuluar nga Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë. Protestuesit, të cilat kërkonin dorëheqjen e Lukashenkos, u përballën me arrestime masive, tortura të pretenduara dhe shtypje të dhunshme, që shkaktoi vdekjen e disa personave.

Shtëpia e Bardhë ia tregoi gabimisht një gazetari planet për luftën në Jemen

WASHINGTON, 25 MARS - Zyrtarët e lartë të sigurisë kombëtare të presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, përfshirë sekretarin e Mbrojtjes, shkëmbyen mesazhe në lidhje me sulmet ajrore ushtarake në Jemen, në një aplikacion të sigurt për dërgimin e mesazheve, në të cilin ishte përfshirë edhe kryeredaktori i The Atlantic, raportoi kjo magazinë të hënën. Këshilli i Sigurisë Kombëtare i Shtëpisë së Bardhë tha se mesazhet e shkëmbyera “duket të jenë autentike”. Trumpi u tha gazetarëve fillimisht se nuk ishte në dijeni se informata tejet të ndjeshme ishin shpërndarë. Biseda mes zyrtarëve të lartë në këtë grup “përmblote hollësi operacionale për sulmet e ardhshme ajrore kundër grupit të mbështetur nga Irani, Huthi, në Jemen, përfshirë të dhëna për objektivat, për armët që do të



dislokonte ShBA-ja dhe për komandën e sulmeve”, tha kryeredaktori Jeffrey Goldberg. Nuk është ende e qartë nëse hollësitë e operacionit ushtarak ishin të klasifikuara, por ato shpesh janë të tilla dhe të paktën ruhen të fshehura për t’i mbrojtur shërbyesit ushtarakë dhe sigurinë operacionale. SHBA-ja ka kryer sulme ajrore kundër rebelëve Huthi prej kur

grupi militant filloi t’i sulmoi anijet tregtare dhe ushtarake në Detin e Kuq në nëntor 2023. Pak orë pasi Goldberg i pranoi hollësitë e sulmit më 15 mars, ShBA-ja filloi bombardimet ndaj objektivave të rebelëve Huthi në Jemen. Këshilli i Sigurisë Kombëtare tha në një komunikatë se është duke e hetuar se si ndodhi që numri i një gazetari u shtua në

grupin e bisedave në aplikacionin Signal. Përveç sekretarit të Mbrojtjes Pete Hegseth, pjesë e grupit ishin edhe nënpresidenti JD Vance, sekretari i Shtetit Marco Rubio dhe Tulsi Gabbard, drejtoresha e Inteligjencës Kombëtare. Goldberg tha se ftesën në Signal e mori nga Mike Waltz, këshilltari i Trumpit për siguri kombëtare, i cili ishte pjesë e grupit gjithashtu. Duke folur për herë të parë për këtë çështje, Hegseth e sulmoi Goldbergun duke e quajtur “mashtues” dhe “të ashtuquajtur gazetari”, duke iu referuar raportimit kritik të kësaj reviste për Trumpin në të kaluarën. Ai nuk dha asnjë sqarim se pse ishte përdorur aplikacioni Signal për të biseduar për operacionin e ndjeshëm, apo se si përfundoi Goldberg në grupin e mesazheve. “Askush nuk po dërgonte mesazhe për

planet për luftë, dhe kaq kam për të thënë për këtë çështje”, tha Hegseth për gazetarë të hënën. Në një komunikatë të hënën në mbrëmje, zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Karoline Leavitt, tha se presidenti ende ka “besim të plotë” në Waltzin dhe ekipin e sigurisë kombëtare. Më herët të hënën, Trump u tha gazetarëve: “Nuk di asgjë për këtë. Po ma thoni për herë të parë”. Ai shtoi se The Atlantic “nuk është ndonjë revistë e madhe”. Zyrtarët qeveritarë e kanë përdorur Signal për komunikime organizative, por ai nuk është mjet i klasifikuar dhe mund të hakohet. Ekspertët e privatësisë dhe teknologjisë thonë se aplikacioni i njohur për dërgimin e mesazheve dhe për thirrje është më i sigurt se aplikacionet e tjera tradicionale.

Trumpi do të vendosë 25 % tarifë ndaj shteteve që blejnë naftë dhe gaz prej Venezuelës

WASHINGTON, 25 MARS - Presidenti amerikan Donald Trump ka thënë se çdo shtet që blen gaz apo naftë prej Venezuelës, do të paguajë tarifë prej 25 për qind në tregtinë që bën me Shtetet e Bashkuara. “Tarifat sekondare” do të hyjnë në fuqi më 2 prill, ka thënë Trumpi përmes një postimi në platformën e tij Truth Social. Trumpi ka thënë se e ka marrë këtë vendim, sepse Venezuela ka dërguar “dhjetëra mijëra” njerëz në ShBA, të cilët kanë “natyrë shumë të dhunshme”. Ky njoftim e rriti çmimin e

naftës së papërpunuar për gati 1.5 për qind. Më herët gjatë këtij muaji, Trumpi e ka pezulluar për 30 ditë licencën që i ka dhënë ShBA-ja kompanisë së naftës, Chevron, e cila prej vitit 2022 ka operuar në Venezuelën e sanksionuar. Presidenti e ka marrë këtë vendim pasi e ka akuzuar presidentin Nicolas Maduro se nuk ka bërë përpunim të mjaftueshëm për reformat zgjedhore dhe kthimin e migrantëve. Trumpi ka thënë më herët gjatë muajit se e ka fuqizuar Aktin

1798 për Armiqtë e Huaj për të arsyetuar dëbimin e anëtarëve të dyshuar të bandës venezuelase Tren de Aragua, pa pasur urdhra përfundimtarë të gjyqtarëve për imigrim. Kina, e cila veçse është e prekur nga tarifat amerikane, është blerësja më e madhe e naftës së Venezuelës. Në shkurt, Kina ka pranuar direkt ose indirekt 503.000 fuçi naftë në ditë prej Venezuelës. Spanja, Italia, Kuba dhe India janë konsumatorët tjerë të naftës venezuelase. Qeveria e Maduros nuk e ka komentuar këtë vendim.



SONDAZHI I PARLAMENTIT EVROPIAN: SHËNOHET REKORD BESIMI NË BE

PRISHTINË, 25 MARS - Një sondazh i fundit i Eurobarometrit, i kryer nga Parlamenti Evropian, tregon një rritje të numrit të qytetarëve evropianë që besojnë se vendi i tyre ka përfituar nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian. Megjithatë, një pjesë e madhe e tyre mbeten pesimistë për vitet e ardhshme, veçanërisht në aspektin ekonomik dhe social. Sipas sondazhit, 74 % e qytetarëve në të gjitha vendet anëtare të BE-së besojnë se vendi i tyre ka përfituar nga anëtarësimi, duke shënuar nivelin më të lartë të regjistruar ndonjëherë që nga viti 1983. Edhe në Hungarinë e udhëhequr nga Viktor Orbán, kjo shifër arrin 74 %, duke tejkaluar Italinë (67 %) dhe Francën (65 %).

Megjithatë, kur pyeten drejtpërdrejt për qëndrimin ndaj BE-së, vetëm 50 % e evropianëve kanë një mendim pozitiv, ndërsa 15 % mbajnë një pikëpamje negative dhe 34 % janë neutralë. Pavarësisht prej rritjes së vlerësimit ndaj BE-së, sondazhi zbulon një tendencë pesimiste për të ardhmen. Një e treta e evropianëve presin që standardi i tyre i jetesës të ulet në pesë vitet e ardhshme, një rritje prej 7 % krahasuar me sondazhin e korrikut 2023. Pritshmëritë më negative janë në Francë (53 %) dhe Gjermani (47 %), ku shumica e qytetarëve presin një përkeqësim të kushteve të jetesës.

Në një klimë gjeopolitike të paqëndrueshme, evropianët po e shohin BE-në gjithnjë e më shumë si një faktor sigurie. Rreth 35 % e tyre e konsiderojnë paqen dhe rritjen e sigurisë si përfitimin kryesor të anëtarësimit në BE, ndjekur nga 34 % që vlerësojnë bashkëpunimin midis shteteve anëtare.

Në këtë kontekst, BE-ja ka ndryshuar strategjinë e saj për mbrojtjen. Javën e kaluar Komisioni Evropian riemërtoi iniciativën për rritjen e shpenzimeve ushtarake nga "Riarmatosja e Evropës" në "Gatishmëria 2030", duke zgjedhur një qasje më të moderuar.

Gjetjet kryesore të sondazhit

Më shumë se kurrë, evropianët vlerësojnë BE-në: 74 % mendojnë se vendi i tyre përfiton nga anëtarësimi në BE, rezultati më i lartë i regjistruar ndonjëherë.

Nevoja për unitet: 89 % besojnë se më shumë unitet është thelbësor për t'i përballuar sfidat globale, me mbështetje mbi 75 % në çdo vend anëtar.

Roli i Parlamentit Evropian: 62 % e qytetarëve duan një rol më të spikatur për Parlamentin Evropian, një rritje prej gjashtë pikësh krahasuar me vitin e kaluar.

Imazhi i BE-së po



përmirësohet: 50 % e qytetarëve e shohin BE-në pozitivisht, një rritje prej dy pikësh nga pranvera 2024 dhe pesë pikë nga vjeshta 2023.

Siguria dhe mbrojtja në fokus: 66 % e qytetarëve duan që BE-ja të ketë një rol më të rëndësishëm në mbrojtjen e tyre nga krizat dhe rreziqet globale.

Prioritetet e BE-së sipas qytetarëve: 36 % e evropianëve duan që BE-ja të fokusohet në mbrojtjen dhe sigurinë, ndërsa

32 % e shohin konkurrencën dhe ekonominë si prioritet.

Pritshmëritë për jetesën: 33 % e evropianëve presin që standardi i tyre i jetesës të ulet në pesë vitet e ardhshme, shtatë pikë më shumë se pas zgjedhjeve të fundit evropiane. Inflacioni, shqetësimi kryesor: 43 % e qytetarëve kërkojnë që Parlamenti Evropian t'i japë përparësi luftës kundër inflacionit dhe rritjes së kostos së jetesës.

Arsyet e mbështetjes për BE-në

kanë ndryshuar: Mbrojtja e paqes dhe forcimi i sigurisë tani është arsyeja kryesore pse qytetarët e shohin anëtarësimin në BE si të dobishëm (35 %), duke kaluar përmirësimin e bashkëpunimit mes vendeve (34 %).

Vlerat themelore mbeten të pandryshuara: Paqja (45 %), demokracia (32 %) dhe të drejtat e njeriut (22 %) janë ende tri vlerat kryesore që qytetarët duan që BE-ja të mbrojë.

LV-ja: QEVERIA KURTI E PËRMBUSHI MANDATIN E PLOTË ME PËRKUSHTIM E PUNË TË PALODHSHME PËR TA ÇUAR REPUBLIKËN PËRPARA



PRISHTINË, 25 MARS - Lëvizja Vetëvendosje ka publikuar të martën një video me të cilën ka paraqitur, siç thotë, të arriturat gjatë mandatit katërvjeçar.

Në të thuhet se qeveria Kurti është "qeveria e parë në historinë tonë politike që realizon një mandat të plotë". "Pandemia, lufta në Ukrainë, kriza energjetike, inflacioni, sulmet terroriste në veri. Duke tejkaluar me sukses çdo sfidë,

qeveria Kurti e përmbushi mandatin e plotë me përkushtim e punë të palodhshme për ta çuar Republikën përpara", thuhet në këtë video.

Më tutje thuhet se ky mandat katërvjeçar u shënuar nga suksese të rëndësishme dhe sfida të mëdha. "Katër vite për Republikën, katër vite që i dhanë shtetit themel të fuqishëm dhe qytetarëve

dinjitet. Kosova sot është më e sigurt, më e fortë dhe më e zhvilluar se kurrë më parë, me rend, ligj dhe shpresë në çdo cep të vendit. Zgjedhjet e 9 shkurtit dëshmuar punën tonë të mirë gjatë këtij mandati. Na presin shumë punë të mira edhe në mandatin e ardhshëm. Po jetojmë në rrethana të vështira globale, por vetëm me qeverisje të mirë mund të triumfojmë", thuhet në këtë postim.

Për tre muaj qytetarët e Kosovës investuan 32 milionë euro në Shqipëri

Prishtinë, 25 mars - Investimet e huaja në Shqipëri kanë arritur një vlerë rekord në fund të 2024-s, 423 milionë euro. Në një vit ky tregues është rritur 29 milionë euro, ndërsa nga tremujori i tretë në të katërt 12 milionë euro.

Edhe pse qeveria ka shprehur shqetësim për origjinën anonime të investitorëve të

huaj në Shqipëri, statistikave të Bankës së Shqipërisë tregojnë se pjesa më e madhe e investimeve, 96 milionë euro, vjen nga burime "konfidenciale". Për një vit, investimet anonime janë shtuar 43 milionë euro.

Holanda vazhdon të kryesojë me investimet e huaja në Shqipëri, me 58 milionë euro

(+1 mln), ndjekur nga Turqia me 53 milionë euro, por me rënie 3 milionë euro. Lista vazhdon me Italinë me 52 milionë euro investime (-3mln). Një rritje e fortë për tremujorin e fundit vërehet në investimet nga Kosova, në 32 milionë euro, nga 22 milionë që ishte tremujorin e parafundit të vitit.





SIPAS KE-së, KOSOVA S'MUND T'I MARRË MILIONAT E PARË NGA PLANI I RRITJES PA U KONSTITUUAR KUVENDI

PRISHTINË, 25 MARS - Kosova dhe Komisioni Evropian janë duke finalizuar hapat proceduralë përmes të cilëve do të bëhet ekzekutimi i 7 % të shumës totale të paraparë për Kosovën nga Plan i Rritjes për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, sipas kërkesës së Kosovës. Nëse Kosova arrin që në Kuvend ta ratifikojë këtë, pagesat e para të rregullta do të bëheshin ndërmjet tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2025, ka thënë një zëdhënës i Komisionit Evropian për gazetën "Express". "Kosova ka bërë kërkesën për lëshimin e parapagimit deri në 7% të shumës totale të parashikuar nën këtë aranzhman [nga shuma fillestare treguese e financimit në dispozicion për secilin përfitues]. Komisioni dhe Kosova tani po përfundojnë hapat proceduralë, të cilat duhet të lejojnë që lëshimi i parapagimit të realizohet sa më shpejt të jetë e mundur në vitin 2025, në pritje të procesit të ratifikimit nga Kosova. Pagesat e para të rregullta priten të realizohen ndërmjet tremujorëve të dytë

dhe të tretë të vitit 2025, pas përmbushjes së kushteve të lidhura me reformat", ka thënë Komisioni. KE thotë se Plan i Rritjes për Ballkanin Perëndimor ofron një udhërrëfyes për t'i sjellë ekonominë e Ballkanit Perëndimor më afër Bashkimit Evropian. Plan i rritjes është 6 miliardë euro investime dhe parimi është edhe investime edhe reforma. Ai, gjithashtu, siguron një qasje graduale në 'tregun e vetëm', duke u lejuar qytetarëve në Ballkanin Perëndimor të marrin disa përfitime të hershme nga integrimi në BE. Zëdhënësi i KE-së për "Express" tregoi edhe ku gjendet Kosova në këtë proces. "Për sa i përket procesit - deri më sot, ne kemi pesë agenda ambicioze reformash në fuqi - duke përfshirë Kosovën, dhe në këmbim, këto reforma mbështeten nga investime. Lidhur me Kosovën, ajo i dorëzoi Komisionit në korrik Agjendën e saj të Reformës, duke mbuluar si reformat në fushën themelore ashtu edhe reformat socio-ekonomike.

Komisioni ka vlerësuar Agjendën e Reformës dhe ka arritur në përfundimin se ajo është në përputhje me objektivat dhe kërkesat e Facility (Reforma dhe Rritja). Agjenda e Reformës u miratua më 23 tetor 2024 përmes një Vendimi Zbatues të Komisionit, pas një opinioni pozitiv nga shtetet anëtare".

Cilat janë kushtet e pagesave?

Risia kryesore e Mjetit të Reformës dhe Rritjes (RGF) është se mbështetja financiare e BE-së do të varet nga zbatimi i suksesshëm i reformave. Në Agjendën e Reformës, reformat ndahen në hapa sasiorë dhe cilësorë, të cilët do të shërbejnë si kushte pagese dhe çdo hap ka një afat kohor zbatimi. Fondet përkatëse në kuadër të aranzhmanit do të lirohen dy herë në vit, në bazë të një kërkesë të paraqitur nga përfituesit dhe verifikuesit, nga Komisioni, të tre grupeve të kushteve të vendosura:

parakushtet, kushtet e përgjithshme dhe kushtet e pagesës. (Për parafinancimin: kërkohe vetëm parakushtet dhe kushtet e pagesës). Parakushtet përfshijnë kushtëzimin standard që duhet të përmbushet në çdo kohë, përkatësisht që përfituesit të vazhdojnë të mbështesin dhe respektojnë mekanizmat efektivë demokratikë, duke përfshirë një sistem parlamentar shumëpartiak, zgjedhje të lira dhe të ndershme, media pluraliste, një gjyqësor të pavarur dhe sundim të ligjit, dhe të garantojnë respektimin e të gjitha detyrimeve të të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e personave që iu përkasin minoriteteve. Për Serbinë dhe Kosovën ekziston gjithashtu një parakusht specifik, domethënë që të angazhohen në mënyrë konstruktive për normalizimin e marrëdhënieve të tyre, me progres të matshëm dhe rezultate të prekshme, me synimin për t'i zbatuar plotësisht të gjitha detyrimet e tyre përkatëse që rrjedhin nga

marrëveshja e vitit 2023 për Rrugën drejt Normalizimit dhe Aneksi i Zbatimit të saj, si dhe të gjitha negociatat e kaluara të dialogut për marrëveshjet e normalizimit dhe të angazhohen në Marrëveshjen Gjithëpërfshirëse të Normalizimit. Kushtet e përgjithshme përfshijnë stabilitetin makro-financiar, menaxhimin e shëndoshë të financave publike, transparencën dhe mbikëqyrjen e buxhetit. [Janë të njëjta si për mbështetjen buxhetore]. Kushtet e pagesës janë specifike për çdo përfitues dhe përcaktohen në çdo agjendë reforme. Deri tash Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut janë vendet e para nga Ballkani Perëndimor ndaj të cilave janë bërë pagesat e parafinancimit. Komisionarja e KE-së për Zgjerim, Marta Kos, një ditë më parë në "X" i uroi Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut për "vendosjen e ritmit në Ballkanin Perëndimor për të marrë parafinancim sipas Planit të Rritjes".

BURIM RAMADANI: KUSHDO NGA OPOZITA QË NUK BASHKËPUNON, I SHËRBBEN QEVERISË IZOLUESE TË KURTIT

Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Burim Ramadani, ka thënë se qytetarët kanë votuar për qeveri të re, jo për vazhdim të qeverisjes izoluese. Sipas tij, në ditët e ardhshme Gjykata Supreme do të pritët ta japë verdiktin mbi ankesat zgjedhore. Ramadani thotë se nëse kjo mundëson certifikimin e rezultateve, procesi për ndërtimin e institucioneve duhet të fillojë. Ai ka thënë se kushdo nga opozita që nuk bashkëpunon, i shërben qeverisë izoluese të Kurtit. Ramadani ka theksuar se ngërçin institucional të mundshëm duhet ta tejkalojë opozita



qeveri stabile dhe kompetente që i adreson nevojat e brendshme reformatore dhe zhvillimore. “Sidomos një qeveri që di me navigu në botën e trazuar ku arkitektura e sigurisë dhe aleancat historike globale po shemben si kurrë më parë gjatë 100 viteve të fundit”, ka thënë Muharremi.

Ndërkaq ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Burim Ramadani, ka thënë se kushdo nga opozita që nuk bashkëpunon, i shërben qeverisë izoluese të Kurtit. Ai ka thënë se ngërçin institucional të mundshëm duhet ta tejkalojë opozita. “Qytetarët kanë votuar për qeveri të re, jo për vazhdim të qeverisjes izoluese. Në ditët e ardhshme Gjykata Supreme do të pritët të jep verdiktin mbi ankesat zgjedhore. Pastaj, nëse kjo mundëson certifikimin e rezultateve, procesi për ndërtimin e institucioneve duhet të fillojë. Prandaj, opozitarët e deritashëm duhet të ulen dhe bëjnë marrëveshjen për qeveri të re, qeveri të stabilizimit të Kosovës”, ka shkruar Ramadani në “Facebook”.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 MARS - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar rezultatin e zgjedhjeve të 9 shkurtit, por ende nuk ka asnjë lëvizje për formimin e institucioneve të reja, pasi Gjykata Supreme e Kosovës është duke u marrë me disa ankesa të partive politike. Gjykata Supreme e Kosovës refuzoi të hënën një ankesë të

Partisë Demokratike të Kosovës për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, duke e konsideruar të pabazë. E në shqyrtim i ka edhe dy ankesa, vendimi për të cilat “do të merret brenda afatit ligjor”. Përveç PDK-së, në këtë gjykatë u drejtuan më 21 mars edhe Lëvizja Vetëvendosje, edhe koalicioni në mes të Partisë Demokratike të Ashkalinjve të Kosovës dhe Lëvizjes për Bashkëveprim, pasi Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe

Parashtesa i refuzoi ankesat e tyre të pabaza. Nga dita e pranimit të ankesave, Supremja i ka 96 orë kohë për ta marrë vendimin. Për dallim nga Albin Kurti që thotë se do ta formojë vetë qeverinë, duke përjashtuar koalicionin me opozitën aktuale, liderët e opozitës ende nuk kanë një qëndrim se a do të jenë në një bllok në rast se Kurti dështon ta formojë qeverinë e re të dalë nga zgjedhjet e 9

shkurtit. Analisti politik Shenoll Muharremi ka thënë se sot askush nuk e ka shumicën, nuk i ka votat dhe mandatet e nevojshme për ta krijuar qeverinë. LDK-ja deri më tani ka thënë se do të qëndrojë në opozitë, duke u bërë kështu njëfarë pengese që opozita të mendojë për formimin e qeverisë. Analisti Muharremi ka theksuar se Kosova ka nevojë për një

KUR DUHET TË JAPIN DORËHEQJE ANËTARËT E QEVERISË?

PRISHTINË, 25 MARS - Dilema të mëdha janë ngritur se kur duhet të japin dorëheqje kryeministri dhe ministrat të cilët janë zgjedhur deputetë të Kuvendit të Kosovës. Në shoqërinë civile janë të ndarë se a duhet të ndodhë kjo para certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të 9 shkurtit apo në momentin e betimit si deputet në parlament.

Sipas Ligjit për Qeverinë - pikës 1 të nenit 26, “në rast se anëtari i Qeverisë në detyrë zgjidhet deputet i Kuvendit, ai duhet të jap dorëheqje nga posti i anëtarit të Qeverisë para ditës së certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve”.

Mirëpo, në Institutin e Kosovës për Drejtësi thonë se nuk është e nevojshme të bëhet dorëheqja, por theksojnë se qeveria do t'i ketë përgjegjësitë e kufizuara pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

Certifikimi i rezultateve mund të bëhet këtë javë nëse respektohen afatet ligjore që kanë të bëjnë me adresimin e ankesave.

Hulumtuesi në IKD, Naim Jakaj, thotë se kryeministri dhe ministrat që janë zgjedhur deputetë, dorëheqjen duhet ta bëjnë pas betimit në legjislativ. Kësisoj, thekson ai, se mirëmbahen dhe funksionojnë institucionet. Sipas tij, duhet bërë interpretim logjik i Kushtetutës, pasi “ka



mospërputhje në lidhje me fillimin e mandatit të deputetit” meqë, siç deklaroi ai, diku thuhet se “nis me t'u certifikuar rezultatet e diku me t'u konstituuar Kuvendi”. “Qeveria është në detyrë, ministrat janë në detyrë, rrjedhimisht pjesa ku ministrat të cilët janë zgjedhur deputetë si dhe kryeministri, nuk duhet të japin dorëheqje. Ligji që është miratuar në vitin 2022 është një ligj i dobët, meqenëse nga Kushtetuta e Kosovës është interpretuar një dispozitë që nuk është zbatuar asnjëherë dhe mund të konsiderohet e vdekur për nga interpretimi juridik. Në këtë mënyrë ajo është bërë copy-paste. Ministrat që janë zgjedhur deputetë dorëheqjen duhet ta japin pas betimit që e

bëjnë si deputetë në Kuvend dhe jo një ditë para certifikimit të zgjedhjeve. Te neni 66 i Kushtetutës së Kosovës thuhet që Kuvendi ka mandat 4-vjeçar, ku brenda 30 ditëve kur mbahet seanca konstituive. Ndërkohë sikur të fillonte mandati sipas nenit 70 paragrafi 2, atëherë Kuvendi do të kishte mandat më shumë se 4-vjeçar dhe do të ishte mandat jokushtetues. Për këtë çështje interpretimi i IKD-së është interpretim logjik i Kushtetutës në mënyrë që të mirëmbahen dhe funksionojnë institucionet”, thekson ai. Por të kundërtën e thonë në Grupin për Studime Juridike dhe Politike. Sipas hulumtuesit Levik Rashiti, në bazë të nenit 72 të Kushtetutës, mandati i deputetit fillon ditën e

certifikimit të rezultateve nga ana e KQZ-së. Rrjedhimisht, sipas tij, anëtarët e qeverisë që janë zgjedhur deputetë duhet të japin dorëheqje para certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të 9 shkurtit.

Ai thotë se nëse ata presin betimin në Kuvend për të dhënë dorëheqje, do të kishte një situatë kundër-kushtetuese. “Sipas nenit 72 të Kushtetutës, i cili flet për papajtueshmërinë e funksionit të një deputeti të Kuvendit, mandati i deputetit fillon ditën e certifikimit të rezultateve nga ana e KQZ-së. Por edhe në bazë të nenit 26 paragrafi 1 të Ligjit për Qeverinë, anëtarët e qeverisë duhet të japin dorëheqje para certifikimit të rezultateve nga KQZ-ja, e cila duhet të ndodhë pasi të merren vendimet përfundimtare nga ana e Gjykatës Supreme. Duhet të ketë dorëheqje dhe dorëheqja duhet të vijë para se të certifikohen si deputet, përndryshe do të kishim një situatë kundërkushtetuese. Meqenëse mandati i deputetit fillon ditën e certifikimit, pra që shprehet taksativisht në Kushtetutën e Kosovës, atëherë i bie që para certifikimit, kur edhe fillon mandati i deputetit, duhet të ketë dorëheqje. Betimi vjen pas certifikimit të kandidatëve të cilët janë zgjedhur për deputetë. Në atë rast, nëse pritët pas certifikimit,

atëherë do të kishim një situatë kundërkushtetuese pasi do të kishim një post të cilin do ta ushtronte tanimë deputeti apo deputetja”, thekson Rashiti për “Kosovapress”.

Megjithatë, Jakaj dhe Rashiti pajtohen se qeveria do të ketë përgjegjësi të kufizuara pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të 9 shkurtit.

Hulumtuesi në IKD, Naim Jakaj, thotë se qeveria nuk mund të propozojë projektligje të reja, të marrë nisma për marrëveshje ndërkombëtare e të bëjë emërim.

Qeveria Kurti ka bërë saktësisht katër vjet mandat, prej kur ka marrë detyrën më 22 mars 2021. “Qeveria tashmë konsiderohet në detyrë, me funksione të cilat janë të kufizuara sipas Ligjit për Qeverinë. Nuk miraton projektligje, nuk miraton strategji, koncept-dokumente, marrëveshje ndërkombëtare, s'propozon emërim të bordeve kolegjiale individuale që kërkojnë emërim nga kuvendi dhe vetë qeveria”, ka deklaruar Jakaj.

Përveç zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi dhe ministrit të Infrastrukturës, Liburn Aliu, të cilët nuk kanë qenë fare në listën për kandidatë për deputetë të partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, të gjithë anëtarët e tjerë të kabinetit qeveritar kanë fituar ulëse në legjislativë e nëntë.

Haradinaj dhe Latifi nderuan 49 martirët e fshatit Brestoc

Rahovec, 25 mars - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, së bashku me kryetarin e AAK-së, Ramush Haradinaj dhe me bashkëpunëtorë, nderuan 49 martirët e fshatit Brestoc të vrarë në vitin 1999

nga pushtuesi serb. “Lufta jonë për liri nuk ka pushuar asnjëherë, sepse pushtuesit e kanë zëvendësuar njëri-tjetrin dhe secili ka qenë më i egër se tjetri. Këtë egërsi e pagoi shtrenjtë edhe Brestoci, fshat

që ka numër të madh të të martirizuarve, por nga ky fshat kanë dalë edhe shumë luftëtarë e veprimtarë, të cilët e kanë nderuar emrin e tyre dhe të vendlindjes. Po ashtu, në fushë të nderit kanë rënë 5

dëshmorë, lavdia e të cilëve qëndron si fllad pranveror mbi këtë vend. Lavdi 5 dëshmorëve, 49 martirëve të Brestocit, në mesin e të cilëve edhe 6 personave të pagjetur!”, ka shkruar Latifi në “Facebook”.



PROFESORESHA E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS MERR ÇMIM NË SHBA PËR TË DREJTA TË NJERIUT

PRISHTINË, 25 MARS - Profesoresha e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës dhe gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese, Remzije Istrefi - Peci, është fituese e çmimit të vitit 2024 për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel global. Çmimi për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut jepet nga Samiti Global mbi Kushtetutshmërinë që organizohet nga Universiteti i Teksasit, i vendosur në Austin të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Profesoresha dhe mbrojtësja e Kushtetutës së Kosovës, Remzije Istrefi - Peci, çmimin e mori gjatë Samitit Global mbi Kushtetutshmërinë që u zhvillua nga 20 deri më 22 mars 2025. “Ky çmim është i rëndësishë së veçantë për vendin tonë, Gjykatën



Kushtetuese të Republikës sonë dhe Universitetin e Prishtinës, Fakultetin Juridik ku unë zhvilloj aktivitetet e mia, si gjyqtare dhe si profesoreshë e

të Drejtës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut”, tha Remzije Istrefi - Peci. Samiti Global, me çmimin e të cilit u nderua profesoresha e

Universitetit të Prishtinës, është një konferencë ndërkombëtare që mbulon të gjitha fushat e kushtetutshmërisë. Gjatë tri

ditëve sa zgjat konferenca, mbahen ligjërata dhe panele të ndryshme diskutimi. Gjithashtu, gjatë qëndrimit në Nju-Jork, profesoresha, respektivisht gjyqtarja Remzije Istrefi - Peci, do të mbajë ligjëratë në Institutin Harriman të Universitetit të Kolumbias, me temën “Zbatimi i Konventës së Stambollit përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës”. Konventa e Stambollit, e miratuar nga Këshilli i Evropës në vitin 2011, parandalon dhe lufton dhunën ndaj grave dhe në familje. Remzije Istrefi-Peci ligjëron në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës që nga viti 2008, ndërsa është emëruar gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës më 9 gusht 2018.

KURTI BËRI HOMAZHE NË 26-VJETORIN E MASAKRËS NË TËRNJE TË THERANDËS

THERANDË, 25 MARS - Në përvjetorin e 26 të masakrës në Tërnje të Therandës, kryeministri Albin Kurti ka bërë homazhe dhe vendosur kurora me lule të freskëta pranë varreve të të rënëve të cilët u vranë mizorisht nga forcat e armatosura serbe. “Gjaku i dëshmorëve është në themelet e Republikës”, u shpreh kështu kryeministri Kurti gjatë homazheve, teksa potencoi se “neve na ka ngelur një pjesë më e vogël e punës, por e rëndësishme ta forcojmë shtetin tonë, ta forcojmë shtëpinë e popullit ashtu që brezave të ardhshëm kurrë të mos iu bie që të vuajnë, të kenë dhembje, apo humbje çfarë kaluam ne”. Kryeministri theksoi se 26 vjet më parë, në pranverën e vitit '99, u vranë martirët e dëshmorët e kombit që na kujtojnë se sa i



madh ishte çmimi i lirisë. Ai shpreh respekt të veçantë për nënat shqiptare të cilat i rritën bijat dhe bijtë e tyre për të qenë qytetarë të dinjitetshëm të Republikës, duke shtuar se përkulemi me nderim dhe mirënjohje të thellë e falënderim të përzemërt për të gjithë ata të cilët kontribuan për lirinë e

popullit tonë dhe vendit tonë. Në këto homazhe, krahas kryeministrit Kurti, ishin edhe deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Artan Abrashi, Haxhi Avdyli, Albena Reshitaj, si dhe familjarë të dëshmorëve e të martirëve të kombit, veteranë e invalidë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

PRESIDENTJA OSMANI KUJTON MASAKRËN E CELINËS, TË FORTESËS DHE TË BRESTOCIT: NUK DO TË NDALEMI ASNJËHERË NË KËRKIM TË DREJTËSISË

PRISHTINË, 25 MARS - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka kujtuar masakrën e Celinës, të Fortesës dhe të Brestocit. Ajo ka thënë se do t'i kujtojë martirët dhe do të nderojnë heronjtë e UÇK-së, por nuk do të ndalen asnjëherë në kërkim të drejtësisë. “Më 25 mars 1999, forcat e regjimit gjenocidal të Serbisë, kryen masakra të përgjakshme në fshatrat e Rahovecit, në të cilat vranë 75 civilë në Celinë, 69 në Fortesë, 49 në Brestoc. Në mbrojtje të popullsisë, ranë heroikisht edhe pesë luftëtarë të UÇK-së. Ata u vranë vetëm sepse ishin shqiptarë, vetëm sepse donin liri. Dhimbja mbetet,



drejtësia mungon, por e vërteta nuk zhbëhet. Kujtojmë martirët, nderojmë heronjtë e UÇK-së dhe nuk do të ndalemi asnjëherë në kërkim të drejtësisë!”, ka thënë Osmani në deklaratën e publikuar në faqen e Presidencës në “Facebook”.

Totaj dhe Rohde diskutojnë për projektet që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik në Prizren

Prizren, 25 mars - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Jorn

Rohde, me të cilin kanë diskutuar për projekte që kanë të bëjnë me zhvillim ekonomik si dhe festalet e shumta që organizohen në Prizren gjatë

sezonit veror, të cilat kanë edhe ndikim ekonomik. Po ashtu, Totaj ka thënë se në këtë takim shqyrtuan mundësitë për bashkëpunim të

mëtejshëm në zhvillimin e këtyre aktiviteteve, që kanë rëndësi të veçantë për promovimin e kulturës dhe turizmit në rajon.



Vuçiqi i thotë Sorensenit se serbët në Kosovë ndodhen në një pozitë të vështirë për shkak të lëvizjeve të Prishtinës

PRISHTINË, 25 MARS - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, u takua të martën në Beograd me të dërguarin e Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Peter Sorensen. Në "Instagram", pas takimit, Vuçiqi tha se takimi i tij i parë me të dërguarin e ri për dialogun ishte "i hapur dhe i drejtë".

Ai ka thënë se e ka njoftuar Sorensenin, i cili javën e kaluar e vizitoi Kosovën, "për problemet me të cilat ballafaqohen serbët" atje. "Unë shpreha shqetësim të veçantë për pozitën e vështirë në të cilën ndodhen serbët për shkak të lëvizjeve të shumta përshkallëzuese, të njëanshme dhe të dhunshme të Prishtinës", shkroi Vuçiqi.

Presidenti serb e akuzoi Kosovën se po bën "pengesa të vazhdueshme në procesin e dialogut", duke ripërsëritur se themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë "është parakusht për fillimin e një normalizimi thelbësor të marrëdhënieve". Në tetor të vitit 2023 të dërguarit e atëhershëm të BE-së, të ShBA-së, të Francës, të Gjermanisë dhe të Italisë ua ofruan Kosovës dhe Serbisë një

draft-statut për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, por Kosova nuk ka pranuar ta themelojë atë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, nuk ka pranuar ta dërgojë këtë draft-statut për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës - veprim që do ta shënonte hapin e parë drejt krijimit të Asociacionit.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha më 21 mars se draft-statuti i Asociacionit i hartuar nga BE-ja nuk është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe se këtë ia ka thënë edhe Sorensenit gjatë vizitës së tij në Prishtinë më 17 mars.

Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe parashikon një nivel të caktuar të vetëmenaxhimit për serbët e Kosovës.

Vuçiqi tha se pret nga Bashkimi Evropian ta rrisë angazhimin e tij në mënyrë që ta ruajë besueshmërinë e dialogut dhe të mbajë rol të paanshëm në këtë proces. Ai shtoi se qëndrimi i Serbisë është se vetëm dialogu konstruktiv dhe kompromisi mund të kontribuojnë për paqen dhe stabilitetin afatgjatë në Ballkanin Perëndimor.



Sorenseni në vizitën e tij të parë në Kosovë që nga marrja e detyrës u takua me udhëheqësit institucionalë dhe me përfaqësuesit e opozitës javën e kaluar. Në Prishtinë emisari evropian tha se prioritet për të është të sigurojë takime mes dy shteteve. "Dialogu është për t'u siguruar që të ketë takime. Se a do të

thotë kjo kompromis apo jo, u takon palëve për ta përcaktuar", tha Sorenseni në Prishtinë.

Takimi i fundit në Bruksel i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, në mes të Kosovës dhe Serbisë, ishte zhvilluar më 17 dhjetor të vitit të kaluar. Kosova dhe Serbia dialogojnë nën ndërmjetësimin e

Bashkimit Evropian që nga viti 2011. Në vitet e fundit dialogu është zhvilluar në nivel të lartë mes liderëve të dy vendeve dhe në nivel kryenegociatorësh. Marrëveshja, e cila nuk është nënshkruar, është ligjërish e detyrueshme për palët, ka thënë blloku, i cili i ka akuzuar Kosovën dhe Serbinë për mosnismën e zbatimit të paktit.

Mbahet kuvendi themelues i Shoqatës së Vullnetarëve për Zjarrfikje dhe shpëtim të kryeqytetit

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 MARS - Pas regjistrimit të Shoqatës së Vullnetarëve për Zjarrfikje dhe Shpëtim të Kryeqytetit, në Departamentin për Regjistrimin e Organizatave Joqeveritare të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të martën u mbajt Kuvendi Themelues i Shoqatës së Vullnetarëve për Zjarrfikje dhe Shpëtim të Kryeqytetit.

Kuvendin e përshëndetën kryetari i kryeqytetit, Përparim Rama, drejtori i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë të Kryeqytetit, Lulzim Fushtica dhe komandanti i Brigadës Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit të Kryeqytetit, Malë Gashi.

Rama theksoi se ndiente "një



krenari të veçantë", pasi që "me themelimin e Shoqatës së Vullnetarëve për Zjarrfikje dhe Shpëtim, po i vendosim themelet e një force të re për mbrojtjen e jetëve dhe të pasurive të qytetarëve tanë". Kuvendi themelues miratoi

disa dokumente shumë të rëndësishme për ecjen tutje të funksionalizimit të shoqatës, siç janë Akti Themelues i Shoqatës dhe Rregullorja e Punës së Kuvendit dhe të Organizimit të Brendshëm të Shoqatës së Vullnetarëve për

Zjarrfikje dhe Shpëtim të Kryeqytetit.

Bazuar në rregulloren e aprovuar, Kuvendi zgjodhi kryetarin e Shoqatës, Bajram Rexhepi dhe nënkryetarin e shoqatës, Murat Halimi.

Kuvendi, po ashtu, miratoi

edhe Bordin Drejtues të Shoqatës prej pesë anëtarëve, në radhët e të cilit do të jetë edhe kryetari i Shoqatës dhe Komandanti i Zjarrfikësve Vullnetarë, i cili do të zgjidhet së shpejti nga Bordi.

Kryetari Rama premtoi se ashtu si edhe deri më tani, kryeqyteti dhe ai personalisht do të vazhdojnë ta ndihmojnë këtë organizim jashtëzakonisht të rëndësishëm, duke i informuar të pranishmit se tanimë shoqatës i është ndarë një objekt në lagjen Kolovicë, janë ndarë një pjesë e mjeteve për renovim të objektit, janë alokuar mjete të tjera shtesë për funksionalizimin e Shoqatës, si dhe falënderoi Brigadën Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim që kanë ndarë një kamion zjarrfikjeje për Shoqatën.

Shkumbin Demaliaj ndan rrugët me AAK-në, hap zyrat e Iniciativës Qytetare 'Demokracia'

Deçan, 25 mars - Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Shkumbin Demaliaj, ka njoftuar se ka hapur zyrat e partisë së re,

Iniciativa Qytetare 'Demokracia', kryetar i së cilës është vetë. "Të dashur qytetarë të Komunës së Deçanit. Që nga nesër me datë

26 mars 2025, dyert e Iniciativës Qytetare - DEMOKRACIA janë të hapura për ju duke filluar nga ora 9:00: Adresa: Rr. Sali Çekaj

(ish Restoranti Besiana)", ka njoftuar Këshilli Themelues i Iniciativës Qytetare 'Demokracia'.



Instituti Atlas: Të hiqet TVSh-ja në faturat e rrymës dhe të zbatohet opinioni i Avokatit të Popullit

PRISHTINË, 25 MARS - Nga 1 prilli është paralajmëruar shtrenjtimi i energjisë elektrike për 15 %. Kryetari i Bordit të ZRRE-së, Ymer Fejzullahu, ditë më parë kishte thënë se kërkesat e kompanive për furnizim me energji elektrike ishin që çmimi të rritej për 35 %, por pas konsultimeve u propozua që çmimi të rritet për 15%.

E deri më 28 mars, qytetarët dhe palët e interesit mund të dërgojnë komente te ZRRE sa i përket propozimit për ngritjen e tarifave të energjisë elektrike. Ndërkaq, pas paralajmërimit për rritjen e çmimit të energjisë elektrike, ka pasur reagime të shumta, duke kundërshtuar rritjen e çmimit. Instituti Atlas ka dhënë një

rekomandim për Qeverinë e Kosovës, se si do të mund ta ulte çmimin e rrymës gjatë viteve 2025 dhe 2026. “Nëse ZRRE vendos t’i rrisë të hyrat maksimale të lejuara 15 %, Instituti Atlas kërkon nga Qeveria e Kosovës ta heqë TVSh-në prej 18-përqindësh në faturat e energjisë elektrike dhe ta zbatojë opinionin e

Avokatit të Popullit dhe gjykatave të Kosovës, duke ua kthyer konsumatorëve 132.5 milionë euro të paguara padrejtësisht për konsumimin e energjisë në veri. Zbatimi i këtyre masave do ta ulte çmimin e rrymës 36 % gjatë viteve 2025 dhe 2026”, thuhet në njoftimin e Institutit Atlas.



Clarku: Qëndrueshmëria dhe e ardhmja ekonomike e Kosovës duhet të shkojnë krah për krah

PRISHTINË, 25 MARS - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë organizoi një diskutim virtual me gjeneralin Wesley Clark, ish-komandant suprem i forcave aleate të NATO-së për Evropë dhe anëtar nderi i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë. Ky aktivitet u organizua në shënim të 26-vjetorit të ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë dhe 21-vjetorit të themelimit të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë. Në bashkëbisedimin me drejtorin ekzekutiv të Odës Amerikane, Arian Zeka, gjenerali Clark tha se Kosova ka një pozicion shumë të rëndësishëm strategjik, duke ofruar paralajmërimet e para për kërcënimet ndaj stabilitetit rajonal në Ballkanin

Perëndimor. “Bota po e shikon Kosovën dhe mënyra më e mirë për ta forcuar sigurinë e saj është përmes zhvillimit ekonomik dhe investimeve, veçanërisht nga Shtetet e Bashkuara”, tha Clark. Duke adresuar rolin e Kosovës në çështjet rajonale dhe globale, gjenerali Clark theksoi rëndësinë themelore të sundimit të ligjit, duke i kërkuar Kosovës “të jetë krenare për të, ta forcojë atë dhe ta përdorë atë për ta ndërtuar besimin e investitorëve”. Ai bëri thirrje për investime në infrastrukturë dhe energji, duke vënë në dukje rezervat e bollshme të linjitet të Kosovës, si dhe duke avokuar për transformimin digjital të vendit, përmirësimin e sistemeve tatimore, lidhjen në brezin e gjerë të internetit dhe sigurinë



kibernetike për ta luftuar dezinformimin dhe përmbyshjen e jashtme. Duke folur për përmirësimin e klimës së biznesit, gjenerali Clark inkurajoi Kosovën ta përqafojë bashkëpunimin rajonal me fqinjët si Shqipëria,

Maqedonia e Veriut, madje edhe Serbia, duke theksuar se, “përfundimisht, Serbia do të duhet të pranojë pavarësinë tuaj dhe bashkëpunimi ekonomik do të jetë i pashmangshëm”. Ai theksoi rolin e rëndësishëm të Odës Amerikane në këtë

rrugëtim si gjeneruese e propozimeve të politikave që nxisin investimet e huaja direkte. Referuar njoftimit të Odës Ekonomike Amerikane, ai u bëri thirrje liderëve të Kosovës që të ndjekin qeverisjen e pastër, unitetin politik dhe të mbajnë një baraspeshë të fortë ndërmjet qeverisë dhe sektorit privat. “Vetëm qeveritë nuk mund të nxisin rritjen - ju nevojitet sektori privat, veçanërisht në teknologjinë e informacionit dhe shërbime, ku talenti dhe aftësitë gjuhësore të Kosovës mund të shkëlqejnë”. Krejt në fund, gjenerali Clark foli për rëndësinë e kthimit të të rinjve në Kosovë, për të kontribuar me idetë e tyre për zhvillimin dhe të ardhmen e Kosovës.

Rafuna: Kalimi i shpejtë në tregun e hapur bizneseve mund t’u shkaktojë humbje të mëdha

PRISHTINË, 25 MARS - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, ka ngritur shqetësimin e bizneseve lidhur me ndryshimet e fundit për furnizimin e tyre me energji elektrike. Sipas Rafunës, bizneset nuk janë kundër daljes në tregun e hapur, por shqetësimi kryesor mbetet koha e shkurtër e tranzicionit dhe ndikimi i drejtpërdrejtë në çmimet e prodhimeve. “Le të kuptohemi që në fillim, bizneset nuk i rezistojnë daljes në tregun e hapur. Përkundrazi, tregu i hapur ka qëllim strategjik rritjen e konkurrencës, duke iu mundësuar bizneseve të gjejnë furnizues me çmime më të favorshme dhe furnizim më të qëndrueshëm me energji elektrike. Megjithatë, bizneset janë njoftuar shumë vonë dhe



afati deri më 1 qershor është shumë i shkurtër për t’u përgatitur për këtë ndryshim”, ka theksuar Rafuna në RTV Dukagjini. Sipas tij, Oda Ekonomike ka analizuar situatën dhe ka vërejtur se çmimi i energjisë elektrike

mund të rritet nga 50 % deri në 100 % për bizneset që kalojnë në tregun e hapur. Ky ndryshim automatikisht do të ndikojë në çmimin e produkteve të tyre, duke i bërë ato më të shtrenjta si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë

ndërkombëtar. Në një takim të mbajtur në Odën Ekonomike, me pjesëmarrjen e rreth 100 bizneseve dhe përfaqësuesve të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), bizneset shprehën pakënaqësinë e tyre për mungesën e paralajmërimit të duhur dhe mungesën e një faze tranzicioni. Rafuna ka theksuar se shumë biznese kanë kontrata të lidhura për një vit për shitjen e produkteve të tyre, dhe rritja e menjëhershme e koston e energjisë do të ndikojë negativisht në konkurrueshmërinë e tyre. “Po ashtu, kemi shqetësime serioze edhe për eksportet e bizneseve tona. Nëse rritet çmimi i produkteve për shkak të kostove të larta të energjisë, mund të ulet kërkesa

për produktet e Kosovës në tregun ndërkombëtar, duke vënë në rrezik marrëveshjet tregtare që bizneset kanë ndërtuar me shumë mund”, shtoi Rafuna. Ai vuri në dukje se vendet fqinje si Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë zbatuar subvencione për të ndihmuar bizneset gjatë kalimit në tregun e hapur të energjisë, ndërsa në Kosovë nuk ka asnjë formë mbështetjeje nga institucionet qendrore apo lokale. Në këtë kontekst, Oda Ekonomike e Kosovës ka kërkuar nga Avokati i Popullit që ta shqyrtojë mundësinë për ta çuar këtë çështje në Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar një shtyrje të afatit për të paktën një vit, në mënyrë që bizneset ta kenë kohën e nevojshme për t’u përgatitur.

ATK-ja u bënë thirrje të gjithë tatimpaguesve për deklarimin e pasqyrave financiare

Prishtinë, 25 mars - Administrata Tatimore e Kosovës ka bërë thirrje për deklarim të pasqyrave financiare për të gjithë tatimpaguesit përmes sistemit elektronik EDI. ATK-ja ka theksuar se deklarimi i pasqyrave

financiare kërkohet me Legjislacionin Tatimor dhe Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim. “Obligues për të deklaruar Pasqyrat Financiare janë të gjithë tatimpaguesit, ashtu siç janë të kategorizuar me Ligjin për Kontabilitet,

Raportim Financiar dhe Auditim”, thuhet në njoftim. Pasqyrat Financiare për qëllime të ATK-së do të deklarohen në periudhën dhe afatin kur dorëzohet edhe Deklarata Vjetore për Tatim në të Ardhura Personale/Korporatave, pra nga data 1

janar deri më 31 mars të vitit pasues për vitin paraprak. “Lidhur me plotësimin e Pasqyrave Financiare, keni mundësinë që t’i referoheni udhëzuesit të publikuar në Sistemin Elektronik EDI, gjegjësisht në menynë ‘Ndihmë’”, ka njoftuar ATK-ja.



AMATORËT E TRUMPIT: AKUZA PËR SKUADRËN E PRESIDENTIT, PAS RRJEDHJES SË PLANEVE SEKRETE

Shkelja më e fundit e sigurisë në SHBA: Ekipi i Trump-it akuzohet si ‘totalisht amatorë’
– ndërsa bota reagon me mosbesim ndaj rrjedhjes së planeve sekrete të luftës

Administrata Trump përballet me thirrje për hetime pas ‘shkeljes më befasuese të inteligjencës ushtarake’.

Administrata Trump po përballet me thirrje për hetim pas një incidenti ku një gazetar u shtua gabimisht në një bisedë në grup, ku zyrtarë të lartë amerikanë diskutonin plane për një sulm ndaj rebelëve Houthi. Në një artikull me titull “Administrata Trump më dërgoi aksidentalisht planet e saj të luftës”, Jeffrey Goldberg, kryeredaktor i revistës The Atlantic, zbuloi se “e dinte dy orë para se të shpërthenin bombat e para se sulmi mund të ndodhte”. Grupi përfshinte figura të larta si: Zvpresidenti amerikan JD Vance, Sekretari i Mbrojtjes Pete Hegseth, Këshilltari për Sigurinë Kombëtare Mike Waltz dhe Drejtoresha e Inteligjencës Kombëtare Tulsi Gabbard, dhe të tjerë.

Zëdhënësi i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, Brian Hughes, deklaroi se biseda në grup dukej të ishte autentike.

Emoji dhe informacione të klasifikuara

Fillimisht, Goldberg ishte skeptik për vërtetësinë e grupit dhe mendoi se “dikush mund të shtirë si Mike Waltz për të më ngritur një kurth”.

Por shpejt e kuptoi që nuk ishte kështu, pasi në grup u shpërndanë informacione ushtarake të klasifikuara në mënyrë të hapur, dhe bombat e diskutuara në bisedë nisën të binin mbi Jemen më 15 mars. Pas sulmeve, pjesëmarrësit në chat reagueshan me emoji si: duar në lutje, flamuri amerikan, grusht dhe zjarr – për të shprehur entuziazëm ndaj “suksesit” të sulmeve.

Trump: “Nuk dija asgjë”

I pyetur lidhur me lajmin se zyrtarët e tij të mbrojtjes i kishin dërguar planet e luftës kryeredaktorit të The Atlantic, Donald Trump u shpreh se “nuk dinte asgjë” për këtë histori. Megjithatë, ai u tha gazetarëve se “nuk është një fans i madh” i revistës, duke pretenduar se bëhet fjalë për një media që “është drejt falimentimit”. Demokratët kanë reaguar me kritikë të ashpër ndaj rrjedhjes së informacionit. Kongresmeni Jamie Raskin deklaroi për gazetaren e Sky News, Martha Kellner: “Është një gabim kaq elementar të flasësh për plane lufte dhe strategji ushtarake në



një mënyrë kaq të pakujdesshme, të hapur dhe publike. Pothuajse me siguri janë kryer krime në këtë proces.”

I pyetur për përdorimin e emoji-ve në bisedën në grup, Raskin shtoi: “Nuk më çudit, duke pasur parasysh kush janë.” Ndërkohë, lideri demokrat në Senat, Chuck Schumer, ka kërkuar një hetim të plotë, duke thënë: “Kjo është një nga shkeljet më tronditëse të inteligjencës ushtarake për të cilën kam lexuar në një kohë shumë, shumë të gjatë.”

“FUBAR” – kështu reagoi një kongresmen për lajmin tronditës se zyrtarët e Trump-it diskutuan plane lufte në një bisedë në aplikacionin Signal. “FUBAR” është një akronim i vjetër ushtarak që do të thotë: “Fed Up Beyond All Recognition” (Me të ardh në majë të hundës, sa më s’bëhet). “Ka vetëm një fjalë për këtë: FUBAR,” tha Pat Ryan, përfaqësues demokrat, veteran i ushtrisë dhe anëtar i Komitetit të Shërbimeve të Armatosura në Kongres.

Rrjedhja e informacionit ngre pikëpyetje të mëdha për sigurinë kombëtare, por sipas ekspertëve ligjorë, krijimi i një grupi të tillë në Signal mund të përbëjë shkelje të Aktit për Spiunazh.

Mesazhet godasin Evropën “patetike dhe përfituese”

Përveç inteligjencës ushtarake të klasifikuar që u nda në grupin e diskutimit, Jeffrey Goldberg, kryeredaktor i The Atlantic, pati gjithashtu mundësinë të shohë nga afër mënyrën se si zyrtarët më të lartë amerikanë flasin për aleatët e tyre evropianë. Në bisedat e grupit, u diskutua mundësia që Evropa të paguajë për mbrojtjen që SHBA ofron për rrugët detare të transportit. Mike Waltz, këshilltari për sigurinë kombëtare në Shtëpinë e Bardhë, kritikoi kapacitetet e kufizuara të marinave evropiane, duke shkruar: “Qoftë tani apo pas disa javësh, do të jetë Shtetet e Bashkuara që do të duhet t’i rihapin këto rrugë detare. Sipas kërkesës së presidentit, po punojmë me Departamentin e Mbrojtjes dhe atë të Shtetit për të përcaktuar koston dhe për t’ua faturuar atë evropianëve.”

JD Vance, zvpresidenti amerikan, i shkroi sekretarit të mbrojtjes Pete Hegseth: “Nëse mendon se duhet ta bëjmë, hajde ta bëjmë. Por e urrej faktin

që po i nxjerrim prapë Evropës gështenjat nga zjarri.”

Hegseth u përgjigj: “Zëvendëspresident: E ndaj plotësisht përbuzjen tënde për përfitimin e evropianëve. Është PATETIKE.”

“Totalisht amatorë”: Cili ka qenë reagimi politik në SHBA?

Ka pasur një përplasje të fortë politike në SHBA, si reagim ndaj lajmit se një gazetar u përfshi gabimisht në një bisedë grupi ku u shpërndanë informacione të klasifikuara ushtarake amerikane.


Chuck Schumer, lideri demokrat në Senat, ka kërkuar një “hetim të plotë” dhe ka deklaruar se “pasoja shumë të ashpra” duhet të bien mbi çdo punonjës të qeverisë që ka shpërndarë planet e ndjeshme ushtarake. Një tjetër figurë e lartë demokrate, senatorja Elizabeth Warren, shkroi në rrjetet sociale: “Siguria jonë kombëtare është në duart e amatorëve.” Ajo e quajti rrjedhjen e informacionit si: “Haptazi e paligjshme dhe jashtëzakonisht e rrezikshme,” dhe shtoi: “Çfarë

bisedash të tjera shumë të ndjeshme për sigurinë kombëtare po zhvillohen nëpër grupe chat-i? Ka edhe ndonjë person tjetër të rastësishëm që është shtuar aksidentalisht atje?”

Pete Hegseth, sekretari amerikan i Mbrojtjes, i identifikuar si pjesë e grupit të bisedës, foli me gazetarët në Hawaii për mesazhet e publikuara nga The Atlantic.

Ai tha se Jeffrey Goldberg “nuk është një gazetar serioz”, duke pretenduar se është “i diskredituar rëndë” dhe “shpërndan plehra”. “Askush nuk po shkëmbente plane lufte me mesazhe. Dhe kaq kam për të thënë për këtë çështje.” Mike Johnson, Kryetari republikan i Dhomës së Përfaqësuesve, tha se administrata Trump “e pranoi se ishte një gabim”, por shtoi: “Ajo që pamë, sipas mendimit tim, ishin zyrtarë të lartë që po bënin punën e tyre – dhe po e bënin mirë.”

Pete Buttigieg, ish-sekretar i Transportit në administratën Biden, u shpreh drejtpërdrejt në vlerësimin e tij, duke e quajtur incidentin: “Një dështim epik.” / Sky News – bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Sot zhvillohen ndeshjet çerekfinale të Kupës në hendboll

Sot (e mërkurë) zhvillohen ndeshjet çerekfinale të Kupës së Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve. Prej

orës 18:30 është ndeshja Prishtina - Besa Famgas. Kjo ndeshje zhvillohet në Bardhosh, ndërsa Prishtina do

ta kërkojë befasinë e madhe. Skuadra pejane llogaritet favorite. Prej orës 20:00 janë ndeshjet Llapi - Kastrioti dhe

Vushtrria - Trepça. Derisa fituesi në fuqi i Kupës, Kastrioti, është favorit i madh në ndeshjen në Podujevë. Ndeshje interesante

pritet në Vushtrri. Rahoveci kalon direkt në gjysmëfinale për shkak të tërheqjes së Vjosës nga garat.

Kërkohet bashkëpunim më i thellë Kosovë - Shqipëri në sport



PRISHTINË, 25 MARS - Është mbajtur konferenca sportive e Federatës Shqiptare të Basketbollit, Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, në të cilën është diskutuar për rolin dhe mundësitë për shtrirjen e bashkëpunimit më të thellë të Kosovës dhe Shqipërisë në fushën e sportit. Liga Unike e basketbollit është hapi i parë që është bërë ndërmjet këtyre dy vendeve dhe kjo garë po shihet si derë e mirë edhe për bashkëpunim në sporte të tjera.

Kryetari i FShB-së, Avni Ponari, theksoi se në fillimet e tyre kishin hasur vështirësi për ta organizuar Ligën Unike, por kjo pastaj u shndërrua në një ngjarje shumë të rëndësishme duke hyrë edhe në kalendarin e FIBA-s. “Megjithëse kishim kundërshti, megjithëse kishim lloj-lloj gjërash për të mos e bërë, por arritëm të organizojmë dhe e veçanta është ta certifikojmë në FIBA Evropë. Vetë pjesëmarrja e presidentit të FIBA Evropës në ceremoninë e kësaj ligë ka qenë një ngjarje shumë e rëndësishme për të dy vendet. Ndërmjet basketbollit në Kosovë dhe në Shqipëri janë shumë të mëdha veçanërisht në vlera sepse unë përfitoj nga rasti për ta përgëzuar Qeverinë e Kosovës që e ka miratuar ligjin katër apo pesë vjet më parë një ligj

që është shumë i rëndësishëm”, ka thënë Ponari.

Bashkëpunimi ndërmjet Prishtinës dhe Tiranës, sipas kryetarit të komunës së Prishtinës, Përparim Rama, është shumë i ngushtë, por mund të rritet edhe më shumë në fushën e sportit dhe jo vetëm. “Bashkëpunimi ndërmjet Prishtinës dhe Tiranës si kryeqytete ka qenë i ngushtë gjithmonë, kemi bashkëpunime të ndryshme edhe në fushën e sportit dhe në shumë fusha të tjera, mirëpo gjithmonë mund të jetë edhe më i thellë dhe më i fokusuar si në aspektin e basketbollit. Ne si kryeqytet kemi marrë një numër të madh të iniciativave për ta promovuar sportin. Kemi qenë edhe në diskutim me klubet jo vetëm të basketbollit, por me Asociacionin e Klubeve të Prishtinës, me kryetarin Blerand Stavileci, ku edhe kemi diskutuar për mundësi të ndryshme, sepse kur krijohen numër i madh i ekipeve dhe bëhen bashkë, edhe në aspektin e marketingut e kanë një joshje shumë më të madhe prej bizneseve për t’u ndërlidhur dhe t’i ndihmuar këto klube sportive”, ka deklaruar Rama.

Ndërsa i pari i FBK-së, Arben Fetahu, vuri në pah nevojën e madhe që kanë federatat për të bërë organizime të tilla. “Nuk mund të bëhet kjo punë vetëm me

kapacitetet tona. Na duhet përkrahja e parasë publike, e qyteteve, e MKRS-së, e të gjithë sponsove. Ne jemi me fat në këtë anë të kufirit që e kemi Ligjin për Sponzorizim dhe i kemi klubet tona paksa më të konsoliduara, por kjo është vetëm në anën e meshkujve”, ka thënë Fetahu.

Mbështetjen logjistike dhe financiare për federatat sportive e garanto presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi. “Në këtë mënyrë ne promovojmë vlerat tona, vlerat shqiptare dhe promovojmë sportin në tërësi. Komiteti Olimpik i Kosovës, roli i tij është t’i përkrahë të gjitha federatat, në veçanti në këtë rast edhe Federatën e Basketbollit, një sport që është shumë i dashur për qytetarët e Kosovës, sport shumë atraktiv dhe shumë i mirë që e duan të gjithë dhe unë besoj se është në rrugën më të mirë të mundshme dhe çdo ditë e më shumë po përparon. E dimë sa ka nevojë një federatë ekipore për financa... Shumica e bizneseve e kanë kuptuar rëndësinë, sepse jo vetëm që japin, por edhe përfitojnë nga tatimi në fitim. Besoj se të gjitha federatat në njëfarë mënyrë kanë biznese të caktuara dhe përfitime nga ato”, ka thënë Krasniqi.

Në Prishtinë më 26 dhe 27 mars do të zhvillohet Final 4 i Ligës Unike të Basketbollit.

SHKURT

Torino e dëshiron Muriqin

Vedat Muriqi po kalon nëpër një formë të mirë dhe kjo duket se ka ndikuar që klube të ndryshme të shfaqin interesim për shërbimet e tij. Sulmuesi i Mallorcas mund të rikthehet në Serinë A të Italisë, pasi Torino ka treguar interesim. 30-vjeçari ka kontratë me Mallorcan deri në vitin 2027, kurse kartoni i tij vlerësohet rreth 8 milionë euro. Muriqi këtë sezon ka shënuar 7 gola në 23 ndeshje të luajtura në La Liga, ndërsa në të shkuarën ka qenë pjesë e Lazios, ekip që bën gara në Serinë A të Italisë.

Tri klube interesohen për Rexhbecajn

Futbollisti Elvis Rexhbecaj mund të largohet nga Bundesliga e Gjermanisë. Mesfushori ka kontratë me Augsburgun deri në qershor të vitit 2026 dhe tanimë ka interesime nga jashtë Gjermanisë për të. “Fussballtransfers” raporton se Rexhbecaj ka tri skuadra që kanë shprehur interesim ku mund ta vazhdojë karrierën. Gjiganti skocez Celtic si dhe ai turk Beshiktash e duan shumë reprezentuesin e Kosovës. Por interesim për transferimin e numrit 6 të Kosovës ka shprehur edhe skuadra e njohur italiane Parma që e do transferimin e tij në Serinë A. 27-vjeçari gjithë karrierën ka luajtur në Bundesliga, derisa këtë edicion ka shënuar dy gola dhe ka asistuar në një tjetër në 24 ndeshje zyrtare me fanellën e Augsburgut. Në rast se vendos ta shesë yllin e tyre, Augsburgu synon të fitojë rreth katër milionë euro.

Ismajli do të largohet nga Empoli

Mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë, Ardian Ismajli, ka marrë vendim për të ardhmen e tij dhe, sipas medimeve italiane, ai do të largohet nga

Empoli në fund të sezonit. Thuhet se Ismajli nuk do ta rinovojë kontratën me Empolin që i skadon në verë dhe tashmë ka njoftuar klubin

për vendimin e tij. Ismajli, që është ndër mbrojtësit më të vlerësuar në kampionatin italian, nuk dihet se ku do ta vazhdojë karrierën, por thuhet

se do të mbetet në Serinë A. Më herët interesim për shërbimet e tij kishin shfaqur Interi, Juventus dhe Napoli, skuadra që mund ta transferojnë falas

në verë. Ismajli ka 24 paraqitje këtë sezon në Serinë A, ndërsa pjesë e Empolit është prej vitit 2021 kur iu bashkua nga Spezia.

Enis Zabërgja emërohet shef i skautimit për të rinjtë në KF Llapi

PODUJEVE, 25 MARS - Klubi i Futbollit Llapi ka njoftuar se ish-futbollisti Enis Zabërgja është emëruar shef i skautimit për të rinjtë. Pas një karriere të gjatë në futbollin aktiv, Zabërgja, i cili së fundmi është pensionuar nga futbolli, tani do të marrë rol kyç në

zbulimin dhe zhvillimin e talenteve të rinj, duke ndihmuar në rrugëtimin e tyre drejt ekipit senior. Me përvojën dhe njohuritë e tij, ai pritet të jetë faktor i rëndësishëm në ndërtimin e një baze të fortë të futbollistëve të rinj në klubin

llapjan. “Jam shumë i lumtur që do të jem pjesë e këtij projekti dhe që do të kontribuoj në zhvillimin e talenteve të rinj. KF Llapi gjithmonë ka qenë një klub që u beson të rinjve, dhe unë do ta jap maksimumin për të zbuluar dhe avancuar

futbollistët më të spikatur drejt ekipit të parë”, ka thënë Zabërgja. Me angazhimin e Zabërgjës në këtë rol, KF Llapi mendon për të ardhmen e klubit, duke krijuar një strukturë të fortë për zhvillimin e talentëve dhe avancimin e tyre drejt Evropës.



Ronaldo merr rekordin ‘Guinness’ në fushën e lojës

LISBONË, 25 MARS - Cristiano Ronaldo vazhdon ta shkruajë historinë në futboll. Sulmuesi portugez u nderua me një “Rekord Guinness” përpara ndeshjes kundër Danimarkës në çerekfinalet e Ligës së Kombeve. Kapiteni i Portugalisë ka arritur një tjetër sukses prestigjioz, pasi është bërë futbollisti me më shumë fitore në historinë e kombëtareve. Ai e arriti këtë rekord vitin e kaluar, kur Portugalia mposhti Poloninë 5-1, në një ndeshje ku Ronaldo shënoi dy gola. Me këtë sukses, CR7 ka regjistruar fitoren e tij të 132-të me kombëtaren, duke kaluar ish-shokun e tij të skuadrës te Real Madridi, Sergio Ramos, i cili e mbante rekordin në fjalë me 131 fitore me Spanjën. Ky është një rekord që duket i vështirë për t’u thyer në të ardhmen e afërt, pasi shumica e lojtarëve që i janë afuar kësaj shifre tashmë janë tërhequr nga



futbolli. Iker Casillas mban vendin e tretë me 121 fitore, i ndjekur nga Lionel Messi me 119 dhe Andres Guardado që mbyll top 5-shen me 102 fitore me Meksikën. Ky nuk është rekordi i parë “Guinness” për Ronaldon. Ai tashmë është i njohur si: Golashënuesi më i mirë në

historinë e kombëtareve, me më shumë se 120 gola, Lojtari i parë që ka shënuar 100 gola në Ligën e Kampioneve. Sportisti me më shumë ndjekës në Instagram, mbi 500 milionë fansa. Një tjetër arritje historike për një nga lojtarët më të mëdhenj të të gjitha kohëve në futboll.

Lakersat pësojnë humbje nga Orlando

ORLANDO, 25 MARS - Orlando ishte skena e një ndeshjeje të madhe në NBA, e cila përfundoi me fitoren e Magicut ndaj lakersave (118-106). Franz Wagner, me 32 pikë, tetë asistime dhe pesë kërcime, si dhe Banchero me 30 pikë (9/17 gjuajtje nga fusha) dhe shtatë kërcime, ishin lojtarët kryesorë të ndeshjes, duke mposhtur dyshen Luka Donqiq (32 pikë, shtatë kërcime dhe shtatë asistime) dhe LeBron James (24 pikë, tetë asistime dhe gjashtë kërcime). Skuadra nga Florida e kufizoi ekipin e Los



Anxhelosit në vetëm 18 pikë gjatë periodës së tretë, duke kthyer një disavantazh prej katër pikësh në një avantazh prej 17 pikësh me një seri 23-5, përpara çerekut të fundit. Ndeshja u karakterizua edhe nga një aksion i madh i Franz Wagnerit në fundin e saj. Gjermani fillimisht e detyroi LeBron Jamesit të kryente një

shkelje të rregullit të hapave dhe më pas shënoi në aksionin e ardhshëm. Ndërkohë, Celticsi, me Neemias Queta në lojë, për pak më shumë se një minutë (2 pikë), fitoi ndaj Kingsit (113-95) në Golden 1 Center, Sacramento. Ndeshja u shënuar nga lëndimi i Jayson Tatumit në kyçin e këmbës së majtë.

SHKURT

Gjimshiti: Në vazhdim do të shihni një Shqipëri të bukur

Kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Berat Gjimshiti, është shprehur i lumtur për fitoren që mori Shqipëria ndaj Andorrës në kuadër të kualifikimeve të Botërorit 2026. Shqipëria shënoi fitore me rezultat 3-0 në shtëpi ndaj Andorrës në kuadër të rrethit të dytë kualifikues. “Ishte përgjigjja e duhur jo vetëm për tifozët, por edhe për ne. Ishte e rëndësishme ta rikuperonim ndeshjen me Anglinë. U futëm në fushë, krijuam golin me Manajn, që ishte çelësi për ta fituar ndeshjen. Ishte shumë e vështirë edhe nga lodhja, nuk ke shumë kohë ta shikosh kundërshtarin. Ka qenë shumë e vështirë. Djemtë kanë bërë një ndeshje shumë të mirë. Mund t’i përmirësojmë disa gjëra, por jemi të lumtur me tri pikët”, ka thënë Gjimshiti. “Gjendja është e mirë. Kam një problem prej shumë kohësh në kofshë. Shpresoj që deri në fund të vitit do të mbaj mirë. Folëm me trajnerin dhe stafin, ishte më mirë mos të rrezikoja shumë,. Do të na pëlqente të luanim gjithmonë në sulm, por varet nga kundërshtari dhe kualiteti. Do të përmirësohemi me kalimin e kohës. Do të shikojmë një Shqipëri të bukur, por gjëja më e rëndësishme është ta fitojmë ndeshjen”, është shprehur Gjimshiti.

Blatteri dhe Platini shpallen të pafajshëm

Ish-presidenti i FIFA-s, Sepp Blatter, dhe ish-presidenti i UEFA-s, Michel Platini, janë shpallur të pafajshëm për akuzat e korrupsionit nga një gjykatë zvicerane. Dy vjet e gjysmë pas lirimit të tyre të parë nga akuzat, Blatteri dhe Platini u shpallën të pafajshëm për mashtrim nga Dhoma e Apelit e Gjykatës Penale Zvicerane. Rasti lidhej me një pagesë prej dy milionë frangash zvicerane që Blatter autorizoi për Platinin në vitin 2011. Kjo pagesë ishte një tarifë konsulence për punën e kryer nga Platini midis viteve 1998 dhe 2002, të cilën francezi pretendoi se ishte shtyrë pjesërisht për shkak të mungesës së fondeve të FIFA-s për ta paguar atë menjëherë. Skandali, i cili doli në dritë në vitin 2015 kur Platini ishte president i UEFA-s, u dha fund shpresave të tij për ta pasuar Blatterin, i cili u detyrua të largohej nga FIFA për shkak të kësaj çështjeje.

Lëndohet Davies, mund të mungojë 3-4 javë

Pas Manuel Neuerit, një tjetër dëmtim ka prekur skuadrën e Bayern Munchenit. Nga kombëtarja, ku ishte i grumbulluar, mbrojtësi kanadez Alphonso Davies u detyrua të largohej herët nga fusha. Lëndimi ka ndodhur në ndeshjen e Ligës së Kombeve Concaf midis Kanadasë dhe Amerikës. Lojtari ka pasur një problem me tendinat e gjurit. Davies ka mbërritur menjëherë në Munchen për t’iu nënshtruar analizave më të hollësishme, por ai rrezikon ta humbasë ndeshjen e dyfishtë të Ligës së Kampioneve kundër Interit. Klubi gjerman ende nuk ka bërë asnjë deklaratë zyrtare, pasi pret ta mësojë përgjigjen e analizave. Gjithsesi, gjendja e tij mbahet nën monitorim, por ai nuk do të aktivizohet këtë fundjavë në kampionat. Ndeshja e parë ndaj Interit në çerekfinalet e Ligës së Kampioneve do të luhet më 8 prill.

Mamardashvili, mesazh Alissonit: Në Liverpool shkoj për pozitën e titullarit

Portieri i Gjeorgjisë, Giorgi Mamardashvili, do t’i bashkohet Liverpoolit verën e ardhshme, në një transferim nga Valencia që

tashmë është zyrtarizuar. 24-vjeçari konsiderohet si një nga portierët më të mirë të së ardhmes. Në një intervistë ai i ka

dërguar një mesazh portierit aktual të “Reds” Alisson, duke i thënë se do të kërkojë të luftojë për vendin e titullarit në “Anfield” kur

të transferohet nga Valencia këtë verë. “Unë do të shkoj në Liverpool për të luftuar për vendin e titullarit. Do të shkoj atje për të

stërvitur sa më mirë dhe t’i tregoj aftësitë e mia. Më pas nuk e di se çfarë do të vendosin për portën”, ka thënë Giorgi Mamardashvili.



Në mbështetje të nenit 21.1 dhe nenit 25 pika h) të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 15.06.2008, nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 30.05.2021, lidhur me nenin 22 të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 19.04.2018, e duke u bazuar në vendimin e Komisionit të Auditimit me nr. të protokollit 19/25 të datës 24.03.2025, N.P.L. "Përparimi" Sh. A, me datë 25.03.2025, shpall:

KONKURS PUBLIK I JASHTËM

(Për plotësimin e vendit të lirë për pozitën e punës "Zyrtar për Auditim të Brendshëm")

I. Titulli: Zyrtar për Auditim të Brendshëm

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar në periudhë tre (3) vjeçare, me mundësi të vazhimit.

Përgatitja profesionale: Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike apo fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohet.

Përvoja e punës: Së paku tri (3) vite në kontabilitet dhe auditim.

I raporton: Komisionit të Auditimit.

Koeficienti i pagës: caktohet me vendim të Bordit të Drejtorëve.

Kushtet e veçanta:

- Të përmbushë kriteret për zyrtarë të ndërmarrjes sipas nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.
- Të përmbushë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, (ii) t'i plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) (iii) të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.
- Të jetë ekspert i certifikuar në kontabilitet ashtu si kërkohet me nenin 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.
- Të jetë Auditor i Certifikuar në sektorin publik, certifikatë e cila duhet të jetë e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave, ashtu si kërkohet me nenin 22 Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.
- Njohja e mirë e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, me theks të veçantë Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe plotësim ndryshimet, Ligjin për Shoqëritë Tregtare, Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Ligjin nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, si dhe ligjet të tjera që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e financave publike.
- të ketë aftësi organizative dhe shkathtësi komunikimi.
- Njohja e programeve Microsoft Office.
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi.
- Të mos jetë i dënuar ose nën hetime.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Përpilimi i planit të auditimit të brendshëm të ndërmarrjes konform objektivave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe procedurave të bazuara në legjislacion të aplikueshëm.
- Auditimi i planeve investive financiare, planit vjetor dhe buxhetin vjetor.
- Auditimi i pasqyrës vjetore të bilancit, deklaratat e fitimeve dhe humbjeve, si dhe deklaratave financiare.
- Vlerësimi profesional i shfrytëzimit efektiv të burimeve të ndërmarrjes dhe dhënia e rekomandimeve adekuata për komisionin e auditimit, përkatësisht menaxhmentin e ndërmarrjes.
- Bën kontrollin financiar të pasurisë dhe parave të gatshme
- Udhëheqë dhe organizon auditimin e brendshëm.
- Zbaton të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm.
- Kryen detyrat e përcaktuara nga Komisioni për Auditim, dhe
- Kryen edhe punët tjera të nevojshme.
- Udhëheqë dhe drejton të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm.
- Për punën e tij i përgjigjet Komisionit të Auditimit.

Aplikacionit duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A (i cili merret në zyrën e Sekretarit të ndërmarrjes);
- Një deklaratë nën betim të nënshkruar nga kandidati se i plotëson kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.1 dhe 17.2. (Kjo deklaratë merret në zyrën e Sekretarit të Ndërmarrjes);
- Rezime për jetëshkrimin e kandidatit;
- Letër Motivuese;
- Dëshmitë për kualifikimin Universitar (Diploma të sille të noterizuar);
- Certifikata për Auditor të Brendshëm të lëshuar nga organet përgjegjëse, e cila duhet të jetë valide (Vërtetim për validitetin e certifikatës);
- Certifikata me të cilën dëshmohet se është ekspert në kontabilitet e lëshuar nga organet përgjegjëse, e cila duhet të jetë valide (Vërtetim për validitetin e certifikatës);
- Dëshmitë për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Certifikatën nga Gjykata e cila dëshmon që nuk është e dënuar me aktgjykim të formës së prerë dhe certifikatën nga gjykata me të cilën dëshmon se nuk është nën hetime, të dy (2) dokumentet të sillen në formë origjinale (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);.

➤ Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojnë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

➤ Dokumentet që kërkohet para themelimit të marrëdhënies së punës:

- Vërtetimi për zotësinë e plotë të veprimi.
- Certifikatën shëndetësore.

➤ Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur tridhjetë (30) ditë nga dita e publikimit, i hapur nga data 26.03.2025 deri me datë 25.04.2025 në ora 16:00.

➤ Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim dhe deklaratën nën betim mund ta marrin dhe ta dorëzojnë në zyrën e Sekretarit të N.P.L. "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Aplikacioni duhet të dorëzohet në një kuvertë e cila duhet të jetë e mbyllur. Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe e-mail adresën. N.P.L. "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për informata shtesë mund të kontaktoni në këtë nr. tel. 044 - 157 - 075.


Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

➤ Sqarim

Ndërmarrja ka për qëllim të sqarojë çështjen e termeve të përdorura në aspektin gjinor, meqë rast fjalët dhe titujt e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

➤ Përfundim

N.P.L. "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.



U skladu sa članom 21.1 i članom 25 tačka h) Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima objavljen u Službenom listu Republike Kosovo 15.06.2008, član 13 Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima objavljen u Službenom listu Republike Kosovo 30.05.2021, u vezi sa članom 22 Zakona br. 06/L-021 o unutrašnjoj kontroli javnih finansija objavljen u Službenom listu Republike Kosovo 19.04.2018, na osnovu odluke Komisije za reviziju br. Protokola 19/25 od 24.03.2025, NPL "Përparimi" Sh. A, dana 25.03.2025, objavljuje:

STRANO JAVNO TAKMIČENJE

(Za popunu konkursa za radno mjesto „Službenik za internu reviziju“)

I. Naslov: Službenik za internu reviziju

Broj dželata: 1

Radno vrijeme: 40 sati sedmično

Trajanje termina: Na određeno na period od tri (3) godine, sa mogućnošću produženja.

Stručna priprema: Univerzitetska diploma iz ekonomije, prava, javne uprave, javnih finansija ili drugih oblasti studija relevantnih za sektor koji se revidira.

Radno iskustvo: Najmanje tri (3) godine u računovodstvu i reviziji.

Izvještava: Odbor za reviziju.

Koeficijent plate: Imenuje se odlukom Upravnog odbora.

Posebni uslovi:

- Ispunjava kriterijume za službenike kompanije prema članu 13. Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima.
- Ispunjava kvalifikacione uslove iz člana 17.1, (ii) ispunjava kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k) i (l) (iii) Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima.
- Biti ovlašćeni stručnjak za računovodstvo u skladu sa članom 13. Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima.
- Biti ovlašćeni revizor u javnom sektoru, sertifikat koji mora biti izdat od strane Ministarstva finansija ili sertifikat za internog revizora u javnom sektoru od bilo koje relevantne međunarodne ili lokalne institucije u skladu sa kriterijumima koje izdaje ministar finansija, u skladu sa članom 22. Zakona br. 06/L-021 o unutrašnjoj kontroli javnih finansija.
- Dobro poznavanje važećih zakona i propisa, sa posebnim osvrtom na Zakon o javnim preduzećima i izmene i dopune, Zakon o privrednim društvima, Zakon o unutrašnjoj kontroli javnih finansija, Zakon br. 06/L-032 o računovodstvu, finansijskom izveštavanju i reviziji, kao i drugi zakoni koji se odnose na unutrašnju kontrolu i upravljanje javnim finansijama.
- Imaju organizacione sposobnosti i komunikacijske vještine.
- Poznavanje Microsoft Office programa.
- Poznavanje stranih jezika je prednost.
- Ne biti osuđen ili pod istragom.

Opis poslova i odgovornosti:

- Sastavljanje plana interne revizije preduzeća u skladu sa ciljevima, politikama i procedurama interne kontrole na osnovu važećeg zakonodavstva.
- Revizija planova finansijskih investicija, godišnjeg plana i godišnjeg budžeta.
- Revizija godišnjeg bilansa stanja, bilansa uspjeha i finansijskih izvještaja.
- Profesionalna procena efektivnog korišćenja resursa preduzeća i davanje adekvatnih preporuka odboru za reviziju, odnosno menadžmentu preduzeća.
- Vrši finansijsku kontrolu imovine i gotovine
- Vodi i organizuje internu reviziju.
- Sprovodi sve aktivnosti interne revizije.
- Obavlja poslove utvrđene od strane Komisije za reviziju, i
- Obavljaju i druge neophodne poslove.
- Vodi i usmjerava sve aktivnosti interne revizije.
- Za svoj rad odgovara Odboru za reviziju.

Uz prijavu se mora priložiti:

- Obrazac prijave za NPL "Përparimi" Sh. A (koji se dobija u kancelariji sekretara kompanije);
- Potpisana izjava kandidata da ispunjava kriterijume nezavisnosti iz člana 17.1 i 17.2. (Ova izjava se dobija u kancelariji sekretara preduzeća);
- Životopis za biografiju kandidata;
- Motivation Letter;
- Dokaz o univerzitetskoj kvalifikaciji (diploma mora biti ovjerena);
- Sertifikat internog revizora izdat od strane nadležnih organa, koji mora biti validan (Potvrda o važnosti sertifikata);
- Uvjerenje o stručnom znanju za računovodstvo izdato od nadležnih organa, koje mora biti važeće (Uvjerenje o važnosti uvjerenja);
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Kopija lične karte;
- Potvrda suda kojom se dokazuje da lice nije pravosnažnom presudom osuđivano i uvjerenje suda da nije pod istragom, oba (2) dokumenta moraju se donijeti u originalu (ne starije od šest (6) mjeseci);

> Opšti kriterijumi koje svi kandidati moraju ispuniti.

- Budite državljanin Republike Kosovo.
- Da imaju pun kapacitet za akciju.
- Da vlada najmanje jednim od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

> Potrebna dokumenta prije zasnivanja radnog odnosa:

- Dokaz o punoj poslovnoj sposobnosti.
- Zdravstveni sertifikat.

> Period prijave kandidata i okvirni kalendar procedure zapošljavanja.

Konkurs ostaje otvoren trideset (30) dana od dana objavljivanja od 26.03.2025 do 25.04.2025 u 16:00 sati.

> Kako se prijaviti i komunicirati sa kandidatima

Zainteresovani kandidati mogu preuzeti i predati formular za prijavu i izjavu pod zakletvom u kancelariji sekretara NPL "Përparimi" Sh. A u gradu Vučitrn, ul. "Gjergj Kastriot Skenderbeg" br. 82, (bivši objekat KZK-a u blizini Osnovnog suda u Mitrovici – filijala u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova.

Prijava se podnosi u zatvorenoj koverti. Kandidati koji se prijave moraju tačno navesti svoju adresu, kontakt telefon i e-mail adresu. NPL "Përparimi" Sh. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo. Za dodatne informacije možete se obratiti na ovaj broj. telefon. 044 - 157 - 075.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene, a nepotpune prijave će biti odbijene.

> POJAŠNENJE

Preduzeće ima za cilj da razjasni pitanje pojmova koji se koriste u smislu roda, jer riječi i naslovi jednog roda uključuju i drugi rod.

> ZAKLJUČAK

NPL "Përparimi" Sh. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo, a podstiču se nevećinske zajednice i njihovi pripadnici, osobe sa invaliditetom i nedovoljno zastupljeni pol da se prijave.



Njoftim për ftesë për ofertë / Shprehje Interesi Ndërmarrja Publike Lokale
"Ku'zina" Sh.A.

Për marrje të objektit me qira

Ndërmarrja Publike Lokale "Ku'zina" Sh.A. fton të gjithë të interesuarit për paraqitjen e ofertave për dhënie me qira të objekteve afariste sipas kushteve të mëposhtme:

Kërkesat:

- Objektet **potenciale** duhet të identifikohen, shqyrtohen dhe të vlerësohen për përputhshmërinë e tyre me kushtet për funksionimin e ndërmarrjes.
- Sipërfaqja minimale e kërkuar:** Objekti duhet të ketë të paktën **1200 m²** për të plotësuar nevojat operationale të ndërmarrjes. Së paku **1,000 m²** duhet të jete si një tërësi në një etazhe, ndërsa **pjesa tjetër** mundet me qene e ndare. Sipërfaqja e dedikuar për kuzhine duhet të jete e qasshme për automjete që bëjnë transportimin e artikujve ushqimore dhe ushqimeve të gatshme.
- Vendndodhja:** Objektet duhet të ndodhen brenda një perimetri prej **2 km** nga vendndodhja e ndërmarrjes aktuale.

Dorëzimi i ofertave:

Të interesuarit duhet të dorëzojnë ofertat në pliko të mbyllur, të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar në selinë e **Ndërmarrjes Publike Lokale "Ku'zina" sh. a., rr. Egnatia, Lagjja Ulpianë, Prishtinë.**

Afati për dorëzimin e ofertave është **deri më datën 01 Prill 2025, ora 16:00.** Ofertat e pranuar pas kësaj date nuk do të merren parasysh.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Ieja e ndërtimit me dokumentacionin përcjellës (certifikatë e pronësisë, kopje plani, Hapësira projekti, skica të objektit dhe hapësirës së jashtme, foto);
- Deklaratë nën betim se objekti nuk është në kontest gjyqësor dhe se nuk ka çfarëdo mase të sigurisë nga gjykatat apo organet e tjera publike;
- Oferta financiare, çmimi për m² dhe shuma totale për një muaj, duke përfshirë të gjitha tatimet dhe obligimet e tjera;

Afati i qirasë:

Ofertuesit të suksesshëm do t'i ofrohet kontratë qiraje për një periudhë **dhjetë (10) vjeçare**, me mundësi vazhdimi me kusht të pajtimit të dyanshëm.

Për informata të tjera apo për specifikimet teknike të kërkuara, mund të kontaktoni në adresën elektronike: kuzhinagendrore@gmail.com

NPL "Ku'zina" sh. a. mban të drejtën të kërkojë informata dokumente shtesë nga ofertuesit që do të shprehin interesimin e tyre.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Dardana Solar” SH.P.K. me seli në Graçanicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811921875 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Dardana Solar” D.O.O. Graçanicë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811921875 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Dardana Solar” L.L.C. with headquarters Graçanicë, has come to the decision to quit its business: 811921875 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “ESG Solutions” SH.P.K. me seli në Graçanicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811858896 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “ESG Solutions” D.O.O. Graçanicë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811858896 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “ESG Solutions” L.L.C. with headquarters Graçanicë, has come to the decision to quit its business: 811858896 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5, nenit 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Rregullores nr.4417 të datës 01.12.2024 për organizmin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, nenit 8,10 dhe nenit 12 të Rregullores nr.4074 të datës 31.10.2024 mbi Marrëdhënien në Punë dhe Vendimi nr.1067 të datës 25.03.2025, NPK "Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, më datë 26.03.2025 shpall:

K O N K U R S I J A S H T Ë M

Pozita e punës: Zyrtar për Kamera, GPS dhe Panele Informuese të Autobusëve
Numri i pozitave: 1 (një);
Niveli i Pagës: X
Kohëzgjatja e kontratës: Në afat të pacaktuar
Kualifikimet: Menaxhment dhe Informatikë; Shkenca Kompjuterike; Shkenca Teknike - drejtimi Kompjuterikë; Shkenca Teknike Telekomunikacion
Përvoja e punës: 1 vit përvojë pune
Puna provuese: 3 muaj

Detyrat dhe përgjegjësitë:
Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punës mund të informoheni përmes web: www.trafikurban-pr.com, në vegzën- Rreth Nesh, Raporte/Rregullore.

- Përgatitja profesionale:**
- Diplomë Universitare në drejtimin Menaxhment dhe Informatikë; Shkenca Kompjuterike; Shkenca Teknike - drejtimi Kompjuterikë; Shkenca Teknike Telekomunikacion
 - 1 vit përvojë pune;
 - Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;
 - Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion.

- Dokumentacioni i kërkuar:**
- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://trafikurban-pr.com> në
 - vegzën - Konkurse/Aplikacioni për punë , (Aplikacioni duhet të jetë i nënshkruar nga kandidati në të kundërtën nuk do të pranohet)
 - CV
 - Dëshmi mbi shkollimin;
 - Kopja e letërnjoftimit;
 - Dëshmi mbi përvojën e punës;
 - Certifikatën mbi dënimin penal nga gjykata kompetente që kandidati nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale me dashje (jo më të vjetër se 6 muaj);
 - Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgënjeshttrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

Të drejtë aplikimi në këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com

Konkursi është i hapur nga data **26.03.2025** dhe përfundon më datë **09.04.2025** në ora **24.00**.

Kalendari i përafërt i zhvillimit të procedurave: Pas përfundimit të procedurave të hapjes së konkursit procedurat zhvillimore planifikohet që të përfundojnë më së largu deri më **12.05.2025**.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 20 pikë
- CV – maksimumi 10 pikë

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data:
26.03.2025

NPK “ Trafiku Urban” SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5, nenit 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Rregullores nr.4417 të datës 01.12.2024 për organizmin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, nenit 8,10 dhe nenit 12 të Rregullores nr.4074 të datës 31.10.2024 mbi Marrëdhënien në Punë dhe Vendimi nr.1065 të datës 25.03.2025, NPK "Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, më datë 26.03.2025 shpall:

K O N K U R S I J A S H T Ë M

Pozita e punës: Kondukter
Numri i pozitave: 68 (gjashtëdhjetë e tetë);
Niveli i Pagës: XV (500 euro)
Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj me mundësi vazhdimi deri në digjitalizimin për shitjen e biletave nga Komuna e Prishtinës
Kualifikimet: Shkollim i mesëm
Përvoja e punës: 1 vit përvojë pune
Orari i punës: Puna organizohet me ndërrime

Detyrat dhe përgjegjësitë:
Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punës mund të informoheni përmes web: www.trafikurban-pr.com, në vegzën- Rreth Nesh, Raporte/Rregullore.

- **Përgatitja profesionale:**
 - Diplomë e Shkollës së mesme;
 - 1 vit përvojë pune;
 - Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;
 - Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion.

- Dokumentacioni i kërkuar:**
- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://trafikurban-pr.com> në
 - vegzën - Konkurse/Aplikacioni për punë. (Aplikacioni duhet të jetë i nënshkruar nga kandidati në të kundërtën nuk do të pranohet).
 - CV
 - Dëshmi mbi shkollimin;
 - Kopja e letërnjoftimit;
 - Dëshmi mbi përvojën e punës;
 - Certifikatën mbi dënimin penal nga gjykata kompetente që kandidati nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale me dashje (jo më të vjetër se 6 muaj);
 - Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgënjeshttrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

Të drejtë aplikimi në këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com
Konkursi është i hapur nga data **26.03.2025** dhe përfundon më datë **09.04.2025** në ora **24.00**.

Kalendari i përafërt i zhvillimit të procedurave: Pas përfundimit të procedurave të hapjes së konkursit procedurat zhvillimore planifikohet që të përfundojnë më së largu deri më **12.05.2025**.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 20 pikë
- CV – maksimumi 10 pikë

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data:26.03.2025

NPK “ Trafiku Urban” SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5, nenit 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Rregullores nr.4417 të datës 01.12.2024 për organizmin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, nenit 8,10 dhe nenit 12 të Rregullores nr.4074 të datës 31.10.2024 mbi Marrëdhënien në Punë dhe Vendimi nr.1066 të datës 25.03.2025, NPK "Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, më datë 26.03.2025 shpall:

K O N K U R S I B R E N D S H Ë M

Pozita e punës: Shofer Autobusi
Numri i pozitave: 28 (njëzetë e tetë);
Niveli i Pagës: X
Kohëzgjatja e kontratës: Në afat të pacaktuar
Kualifikimet: Shkollim i mesëm
Përvoja e punës: 2 vit përvojë pune në fushën e vozitjes në mjete të kategorisë "D"
Periodha provuese: 3 muaj

Detyrat dhe përgjegjësitë:
Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punës mund të informoheni përmes web: www.trafikurban-pr.com, në vegzën- Rreth Nesh, Raporte/Rregullore.

Përgatitja profesionale:

- Diplomë e Shkollës së mesme;
- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion.

Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://trafikurban-pr.com> në
- vegzën - Konkurse/Aplikacioni për punë, (Aplikacioni duhet të jetë i nënshkruar nga kandidati në të kundërtën nuk do të pranohet).
- CV
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Certifikatën mbi dënimin penal nga gjykata kompetente që kandidati nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale me dashje (jo më të vjetër se 6 muaj);
- Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com
Konkursi është i hapur nga data **26.03.2025** dhe përfundon më datë **09.04.2025** në ora **24.00**.
Kalendari i përafërt i zhvillimit të procedurave: Pas përfundimit të procedurave të hapjes së konkursit procedurat zhvillimore planifikohet që të përfundojnë më së largu deri më **12.05.2025**.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 20 pikë
- CV – maksimumi 10 pikë

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 26.03.2025

NPK " Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Krenare Isa Goronvi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e U.P. "Hasan Prishtina" në Prishtinë, pran Fakultetit Edukimit ne. 1365, 10 mars 2017.

- Vlorand Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e sh.m. ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Astrit Gojani B.I. nga Gjakova shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 810232314 të lëshuar nga ARBK.

- Edona Miftari B.I shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër unik 811326546.

- Egzon Peci shpall te pavlefshme dëftesat e SHMLE "Hasan Prishtina".

- Deli Shala B.I shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër unik 811866823.

- Lindita Muslija shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Andon Zako Çajupi".

- A.C.E.S. Pet Home SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812048735.

- Mirand Shala shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Ymer Prizreni" Prizren.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informa-ta lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Ermbotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

